

# Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 26

## *Kontabiliteti dhe Raportimi për Skemat e Përfitimit të Pensioneve*

### Objekti

---

- 1 **Ky Standard gjen zbatim në Pasqyrat financiare të Skemave të përfitimeve për pensione ku përgatiten këto pasqyra financiare.**
- 2 Skemat e përfitimeve për pensione ndonjëherë gjenden në një shumëllojshmëri emërtimesh të tjera si për shembull ‘Skema të pensionit’, ‘skemat të pagesave mujore për pensione’ ose ‘Skemat e përfitimeve për pensione’. } Ky Standard trajton Skemën e përfitimit të pensioneve si njësi raportuese e posaçme nga punëdhënësit e pjesëmarrësve në këtë skemë. Gjithë Standardet e tjera gjejnë zbatim tek Pasqyrat Financiare të Skemave të përfitimeve për pension për sa kohe që ky Standard nuk i zëvendëson ato.
- 3 Ky Standard e trajton kontabilitetin dhe raportimin në grup skeme të të gjithë pjesëmarrësve. Ai nuk trajton raportet që u drejtohen pjesëmarrësve individuale për të drejtat e tyre të përfitimit të pensioneve.
- 4 SNK 19 *Përfitimet e punonjësve* trajton përcaktimin e kostos së përfitimeve për pension sipas paraqitjes së pasqyrave financiare të kompanive punëdhënëse të përfshira në skemë. Rrjedhimisht, ky Standard plotëson SNK 19.
- 5 Skemat e përfitimeve për pensione mund të jenë skema të kontributeve të përcaktuara ose skema të përfitimeve të përcaktuara. Shumë skema kërkojnë krijimin e fondeve të veçanta, të cilat mund të përmbajnë ose jo identitet ligjor, ose mund të kenë (ose jo) administratorë të besuar ku të derdhen kontributet dhe ku të paguhet përfitimet për pensione. Ky standard zbatohet pavarësisht nga fakti nëse ky fond krijohet ose jo, apo nëse ekzistojnë administratorë të besuar.
- 6 Skemat e përfitimeve për pensione me aktive të investuara në kompani sigurimesh u nënshtrohen të njëjta kërkesave të Kontabilitetit dhe raportimit, siç ndodh me marrëveshjet e investuara privatisht. Kështu, ato janë brenda objektit të këtij Standardi, përveç rastit kur kontrata me shoqërinë e sigurimit është në emër të një pjesëmarrësi apo grupi pjesëmarrësish të caktuar, dhe detyrimi i përfitimeve për pensione janë përgjegjësi që i përket vetëm shoqërisë së sigurimit.
- 7 Ky Standard nuk trajton forma të tjera përfitimesh nga punësimi, si për shembull zhdëmtimet në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, organizime për kompensime të mëvonshme, përfitimet nga lejet e marra gjatë periudhës së punësimit, pensionet e parakohshme të posaçme apo skemat e daljes në reformë, skemat e kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies, apo skema shpërblimesh. Objekti i këtij Standardi gjithashtu përjashton çdo formë sigurimesh shoqërore të organizuar nga aparati shtetëror.

### Përkufizime

---

- 8 **Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard:**

*Skemat e përfitimeve për pensione janë forma organizimi ku njësi ekonomike ofron përfitime për të punësuarit në marrëdhënie pune apo pas përfundimit të tyre (në trajtë të ardhurash vjetore apo shumave fikse që jepen vetëm një herë). Këto përfitime apo derdhja e kontributeve për to përcaktohet ose parashikohet, përpara daljes në pension, nga dispozitat e një dokumenti apo sipas praktikës së njesisë ekonomike.*

*Skemat e kontributeve të përcaktuara janë skema të përfitimeve për pensione ku shumat e pagueshme si përfitime për pensione përcaktohen nga kontributi tek fondi së bashku me fitimet e mëvonshme nga investimi i tyre.*

*Skemat e përfitimeve të përcaktuara janë skema të përfitimeve për pensione ku shumat e pagueshme si përfitime për pensione përcaktohen nga referenca tek formula që përgjithësisht aplikohet bazuar në të ardhurat dhe vitet në punë të punonjësve.*

*Financim quhet transferimi i aktiveve (fondit) tek një njësi ekonomike e ndryshme nga shoqëria punëdhënëse me qëllim përmbushjen e detyrimit të pagimit të përfitimit të pensionit.*

**Ky Standard gjithashtu përmban termat e poshtëshënuar për të cilat jepen përkufizimet:**

*Pjesëmarrësit janë pjesëtarë të skemës së përfitimit të pensioneve dhe persona të tjerë të cilët kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo skemë.*

*Aktivet neto të vlefshme për përfitime janë aktivet e skemës minus detyrimet, të ndryshme nga vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara.*

*Vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara është vlera aktuale e pagesave të pritshme nga skema e përfitimeve për pensione ndaj nëpunësve ekzistues apo të mëparshëm, dhe bazohet në punën e kryer.*

*Përfitimet e kushtëzuara janë përfitime të cilat, sipas kushteve të skemës së përfitimit për pensione, nuk ndikohen nga punësimi i vijueshëm.*

- 9 Disa skema të përfitimeve për pensione kanë financues të ndryshëm nga punëdhënësi; Ky Standard gjen zbatim edhe tek pasqyrat financiare të këtyre skemave.
- 10 Shumë skema të përfitimeve për pensione bazohen në marrëveshje formale Disa skema janë jo-formale, megjithatë kanë fituar një shkallë detyrimi për zbatim si rezultat i praktikave të përcaktuara nga punëdhënësi. Ndonëse disa skema e lejojnë punëdhënësin të kufizojë detyrimet e tij kundrejt skemës, zakonisht ai e ka të vështirë të anultojë skemën në rast se dëshiron të parandalojë ikjen e punëmarrësve nga puna. Si skema formale, ashtu edhe ajo jo-formale mbështeten në të njëjtat baza kontabilizimi dhe raportimi.
- 11 Shumë skema të përfitimeve për pensione sigurojnë ngritjen e fondeve të veçanta ku të derdhen kontributet dhe të paguhet përfitimet. Këto fonde mund të administrohen nga palë që veprojnë në mënyrë të pavarur për menaxhimin e aktiveve të fondit. Në disa vende këto palë quhen administratorë të besuar. Në këtë Standard, termi ‘administrator i besuar’ përdoret për emërtimin e këtyre palëve pavarësisht nga fakti nëse është ngritur ndonjë aktivitet besimi.
- 12 Skemat e përfitimeve për pensione pleqërie normalisht përshkruhen si ‘skema të kontributeve të përcaktuara’ ose ‘skema të përfitimeve të përcaktuara’, dhe secila mbart tiparet e veta dalluese. Ndonjëherë gjenden skema që përmbajnë karakteristika të të dyjave. Në këtë Standard, këto skema hibride cilësohen si ‘skema të përfitimeve të përcaktuara’.

## **Skemat e kontributeve të përcaktuara**

---

- 13 **Pasqyrat financiare të një skeme kontributesh të përcaktuara përmbajnë pasqyrën e aktiveve neto të vlefshme për përfitim dhe përshkrimin e politikës së financimit.**
- 14 Në skemën e kontributeve të përcaktuara, shumat e përfitimeve të ardhshme të një pjesëtari përcaktohet nga kontributi i derdhur nga punëdhënësi, pjesëmarrësi, apo të dy së bashku, dhe eficienta operacionale e fitimeve të përfituara nga investimi i fondit. Zakonisht detyrimi i punëdhënësit përfundon me derdhjen e kontributit tek fondi. Normalisht, këtu nuk kërkohet këshillë nga aktuari, ndonëse kjo këshillë mund të shërbejë ndonjëherë për parashikimin e përfitimeve të ardhshme, të cilat mund të përllogariten duke u bazuar në kontributet aktuale dhe nivelin e ndryshueshëm të kontributeve të ardhshme, dhe tek fitimet nga investimi.
- 15 Pjesëmarrësit janë të interesuar për aktivitetet e skemës meqenëse ato prekin drejtpërdrejt nivelin e përfitimeve të tyre të ardhshme. Ata janë të interesuar të dinë nëse kontributet janë derdhur, dhe nëse është ushtruar kontrolli i duhur për mbrojtjen e të drejtave të palës përfituese. Punëdhënësi interesohet për mbarëvajtjen eficiente dhe funksionimin e drejtë të skemës.
- 16 Objektivi i raportimit periodik të skemës së përcaktuar të kontributit është të japë informacion rreth skemës dhe performancës të investimeve të saj. Zakonisht ky objektivi arrihet kur pasqyra financiare paraqet përmbajtjen e mëposhtme:
  - (a) përshkrim i aktiviteteve thelbësore për periudhën dhe efekti i ndonjë ndryshimi që lidhet me skemën, anëtarësimin në të dhe kushtet e saj.
  - (b) relacione mbi transaksionet dhe performancën e investimit për periudhën, dhe pozicionin financiar i skemës në fund të periudhës; dhe
  - (c) përshkrim i politikave për investim.

## **Skemat e përfitimeve të përcaktuara**

---

- 17 **Pasqyrat financiare të skemës së përfitimit duhet të përmbajnë:**
  - (a) një pasqyrë që tregon:

- (i) **Aktivet neto të vlefshme për përfitime;**
- (ii) **Vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara, duke bërë dallimin midis përfitimeve të kushtëzuara dhe atyre të pakushtëzuara; dhe**
- (iii) **teprica apo deficioni që rrjedhin prej tyre ose**
- (b) **një pasqyrë të aktiveve neto të vlefshme për përfitime, ku të përfshihet:**
  - (i) **një shënim që paraqet vlerën aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara, duke bërë dallimin midis përfitimeve të kushtëzuara dhe atyre të pakushtëzuara; ose**
  - (ii) **referenca tek ky informacion me anë të një raporti aktuarial shoqërues**

Nëse vlerësimi aktuarial nuk është përgatitur në të njëjtën datë me pasqyrën financiare, si bazë merret vlerësimi më i fundit dhe data e bërjes publike të këtij vlerësimi.

- 18 Sipas paragrafit 17, vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara bazohet në përfitimet e premtuara sipas kushteve të skemës për punën e kryer deri në atë datë duke përdorur nivelin korrent ose nivelet e parashikuara të pagës shoqëruar me dhënien e informacioneve shpjeguese për bazën e përdorur. Gjithashtu, do të jepen informacione shpjeguese mbi efektin e ndryshimeve në hipotezat aktuariale me ndikim të madh tek vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara.
- 19 Pasqyra financiare përshkruan lidhjen ndërmjet vlerës aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara dhe aktiveve neto të dhëna për përfitime, dhe politikave të financimit të përfitimeve të premtuara.
- 20 Sipas skemës së përfitimeve të përcaktuara, pagesa e përfitimeve për pension të premtuara varet nga pozicioni financiar i skemës, aftësia e kontribuesve për të derdhur kontribute të ardhshme tek kjo skemë, dhe performanca e investimit dhe efiçenca operacionale e skemës.
- 21 Skema e përfitimeve duhet të përmbajë këshilla periodike nga një aktuar, ku të përfshihet përcaktimi i gjendjes financiare të skemës, rishikimi i hipotezave dhe rekomandimet për nivelet e ardhshme të kontributit.
- 22 Objektivi i raportimit sipas skemës së përfitimeve të përcaktuara është të japë informacion në mënyrë periodike rreth burimeve dhe aktiviteteve financiare të skemës në dobi të vlerësimit të marrëdhënies ndërmjet akumulimit të burimeve dhe përfitimeve të skemës në kohë. Zakonisht ky objektivi arrihet kur paraqiten pasqyra financiare me përmbajtjen e mëposhtme:
- (a) përshkrim i aktiviteteve të konsiderueshme për periudhën dhe efekti i ndonjë ndryshimi që lidhet me skemën, anëtarësimin në të dhe kushtet e saj.
  - (b) relacione mbi transaksionet dhe performancën e investimit për periudhën, dhe pozicioni financiar i skemës në fund të periudhës;
  - (c) informacion aktuarial i paraqitur brenda pasqyrave financiare apo me anë të një raporti të veçantë; dhe
  - (d) përshkrim i politikave për investim.

## **Vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara**

- 23 Vlera aktuale e pagesave të pritshme në skemën e përfitimeve për pension llogaritet dhe raportohet në bazë të nivelit korrent apo të parashikuar të pagës deri në momentin kur pjesëmarrësit në skemë dalin në pension.
- 24 Arsyet e përdorimit të metodës sipas pagës korrente janë:
- (a) vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara, që përfaqëson shumën aktuale gjithsej të secilit pjesëmarrës në skemë mund të përllogaritet në mënyrë më objektive sesa sipas nivelit të pagës së parashikuar meqë hipotezat që do të përdoren janë më të pakta;
  - (b) si rezultat i rritjes së pagës, rritjet në përfitime kthehen në detyrim të skemës; dhe
  - (c) në rast të përfundimit apo ndërprerjes së skemës, shumën e vlerës aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara përgjithësisht lidhet më ngushtë me shumën e pagueshme.
- 25 Arsyet e përdorimit të metodës sipas pagës së parashikuar janë:
- (a) informacioni financiar duhet të përgatitet në bazë vijueshmërie; pa marrë parasysh hipotezat dhe vlerësimet që duhen kryer;
  - (b) sipas skemës së pagës përfundimtare, përfitimet përcaktohen duke u referuar tek paga e marrë në momentin e daljes në pension ose në pagat e marra afër kësaj date; kështu duhen parashikuar pagat, nivelet e kontributit dhe normat e kthimeve; dhe

- (c) nëse nuk i përmbahemi parashikimeve të pagës, ndonëse shumica e financimit bazohet në këtë parashikim, mund të rezultojë që të raportojmë një mbi-financim të skemës edhe pse nuk ka asnjë mbi-financim, ose të raportojmë financim adekuat kur skema është e nën-financuar.

- 26 Pasqyra financiare e një skeme paraqet vlerën aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara e bazuar në pagën korrente, dhe tregon detyrimin për përfitimet e marra deri në datën e përgatitjes së pasqyrës financiare. Vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara e bazuar në pagat e parashikuara, jepet për të treguar madhësinë e detyrimit potencial të bazës së vijimësisë, e cila është përgjithësisht baza për financim. Përveç dhënies së informacioneve shpjeguese për vlerën aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara, duhet të jepet një informacion i mjaftueshëm ku të tregohet qartë konteksti ku duhet parë vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara. Këto shpjegime mund të paraqiten në formë informative rreth përshtatshmërisë së financimit të planifikuar për të ardhmen dhe politikave për financim bazuar në parashikimin e pagës. Këto shpjegime mund të përfshihen në pasqyrën financiare ose në raportin e aktuarit.

## Frekuenca e vlerësimit aktuarial

- 27 Në disa vende, vlerësimet aktuariale kryhen jo më shpesh sesa një herë në tre vjet. Nëse vlerësimi aktuarial nuk është përgatitur në të njëjtën datë me pasqyrën financiare, si bazë merret vlerësimi më i fundit dhe data e dhënies së vlerësimit.

## Përmbajtja e pasqyrave financiare

- 28 Për skemat e përfitimeve të përcaktuara, informacioni duhet të jepet në njërin prej formateve poshtëshënuara, të cilat reflektojnë praktika të ndryshme të dhënies së informacioneve shpjeguese dhe paraqitjes së informacionit aktuarial:

- (a) nje pasqyre që përfshihet ne pasqyrat financiare dhe që paraqet aktivet neto të vlefshme për përfitime, vlerën aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara dhe rezultanten në tepriçë apo deficit. Pasqyrat financiare të skemës gjithashtu përmbajnë pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto të dhëna për përfitim dhe ndryshimet në vlerën aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara. Pasqyrat financiare mund të shoqërohen me një raport të veçantë të aktuarit për argumentimin e vlerës aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara;
- (b) pasqyrat financiare që përmbajnë një pasqyrë të aktiveve neto të vlefshme për përfitime dhe ndryshimet në këto aktive. Vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara paraqitet si shënim i pasqyrave financiare. Gjithashtu, pasqyrat financiare mund të shoqërohen me një raport të aktuarit për argumentimin e vlerës aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara; dhe
- (c) Pasqyrat financiare përmbajnë një pasqyrë të aktiveve neto të vlefshme për përfitime, dhe pasqyrën e ndryshimit të tyre. Vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara jepet me një raport aktuarial të veçantë.

Për secilin format raportimi, nëse raporti i administratorit të besuar tij paraqitet në trajtën e Raportit të Drejtimit apo Raportit të Drejtorëve, ai duhet të shoqërojë pasqyrat financiare me raportin e investimeve.

- 29 Personat që përkrahin formatet e përkrahura në paragrafin 28(a) dhe (b) besojnë se përcaktimi sasior i përfitimeve për pension të premtuara, dhe informacione të tjera të dhëna sipas këtij trajtimi i ndihmojnë përdoruesit që të vlerësojnë gjendjen aktuale të skemës dhe mundësitë se sa janë realizuar detyrimet e skemës. Ata gjithashtu besojnë se vetë pasqyrat financiare duhet të jenë te plota ne vetvete, dhe jo të mbështura ne pasqyra shoqeruese. Megjithatë, disa besojnë se formati i paraqitur në paragrafin 28(a) mund të japë idenë e ekzistencës së pasivit, ndërsa vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara, sipas tyre, nuk i përmban të gjitha tiparet e pasivit.
- 30 Personat që përkrahin formatin e përkrahur në paragrafin 28(c) besojnë se vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara nuk duhet të përfshihet në pasqyrën e aktiveve neto të vlefshme për përfitime siç përcaktohet në paragrafin 28(a), madje as të bëhet i njohur si shënim, siç përcakton paragrafi 28(b), sepse do të krahasohet drejtpërdrejt me aktivet e skemës, dhe një krahasim i tillë mund të mos jetë i vlefshëm. Ata shprehën se nuk është e nevojshme që aktuarët të krahasojnë vlerën aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara me vlerën e tregut të investimeve. Sipas tyre, në vend të këtij krahasimi, aktuarët mund të japin vlerësim të vlerës aktuale të fluksit të mjeteve monetare të pritshme nga investimet. Kështu, personat që përkrahin këtë format besojnë se ky krahasim mund të mos reflektojë vlerësimin e përgjithshëm të skemës nga aktuari, dhe se kjo mund të keqkuptohet. Gjithashtu, disa besojnë se pavarësisht nga fakti nëse mund të jepet përcaktim sasior, informacioni rreth përfitimeve për pension të premtuara duhet të paraqitet vetëm në formën e një raportit të veçantë aktuarial, ku dhe mund të jepet një shpjegim i përshtatshëm.
- 31 Ky Standard pranon pikëpamjet në mbështetje të lejimit të dhënies së informacioneve shpjeguese rreth përfitimeve për pensione të premtuara në një raport aktuarial të veçantë. Standardi hedh poshtë argumentet

kundra përcaktimit sasior të vlerës aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara. Mbi këtë bazë, formatet e përcaktuara në paragrafin 28, pikat (a) dhe (b) shihen si të pranueshme nga Standardi, po ashtu edhe formati i përshkruar në paragrafin 28, pika (c), për sa kohë që pasqyrat financiare përmbajnë referencën në raport dhe shoqërohen me raportin aktuarial ku përfshihet vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara.

## Gjithë Skemat

### Vlerësimi i aktiveve të skemës

- 32 **Skema e Investimeve të përfitimeve për pension do të kryhet në vlerën e drejtë. Në rastin e letrave me vlerë të tregtueshme, vlera e drejtë është vlera e tregut. Kur bëhen investime të skemës për të cilat nuk është e mundur të përcaktohet vlera e drejtë, arsyet e mospërdorimit të kësaj vlere do të argumentohen me informacione shpjeguese.**
- 33 Në rastin e letrave me vlerë të tregtueshme, vlera e drejtë është zakonisht vlera e tregut, sepse është mjeti më i dobishëm për matjen e letrave me vlerë në datën e raportit dhe të performancës së investimit për periudhën. Letrat me vlerë me vlerë fikse riblerjeje (të aksionit), të cilat janë blerë për të përmbushur detyrimet e skemës, apo pjesë të caktuara të saj, mund të barten në shumat që bazohen në vlerën e ri-blejes së fundit, duke supozuar një normë konstante kthimi në maturim. Kur bëhen investime të skemës për të cilat nuk është e mundur të përcaktohet vlera e drejtë, për shembull për pronësinë totale të një njësie ekonomike, arsyet e mospërdorimit të kësaj vlere do të argumentohen me informacione shpjeguese. Nëse investimet kryhen në shumata të ndryshme nga vlera e tregut apo vlera e drejtë, atëherë jepen informacione shpjeguese edhe për vlerën e drejtë. Aktivitetet e përdorura në operacionet me fondin shqyrtohen sipas Standardit përkatës.

### Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 34 **Pasqyrat financiare të skemës për përfitimin e pensione, qoftë përfitim i përcaktuar apo kontribut i përcaktuar, duhet të përmbajnë edhe informacionin e mëposhtëm:**
- (a) **një pasqyrë të ndryshimeve në aktivet neto të vlefshme për përfitime;**
  - (b) **një përmbledhje e politikave kryesore kontabël; dhe**
  - (c) **një përshkrim i skemës dhe ndikimi i çdo ndryshimi në të gjatë periudhës.**
- 35 Pasqyrat financiare të skemës së përfitimeve për pensione duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm, nëse aplikohet:
- (b) një pasqyrë e aktiveve neto të vlefshme për përfitime, ku të paraqiten:
    - (i) aktivet në fund të periudhës të klasifikuara në mënyrë të përshtatshme
    - (ii) baza për vlerësimin e aktiveve;
    - (iii) detajet e çdo investimi që tejkalon 5% të aktiveve neto të vlefshme për përfitime, ose që tejkalon 5% të çdo kategorie apo lloji letrash me vlerë;
    - (iv) detajet e çdo investimi tek punëdhënësi; dhe
    - (v) pasive të tjera veç vlerës aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara;
  - (b) një pasqyrë të ndryshimeve në aktivet neto të vlefshme për përfitime, ku të përfshihen:
    - (i) kontributet e punëdhënësit
    - (ii) kontributet e punëmarrësit.
    - (iii) të ardhura nga investimet, si psh. interesat apo dividendët;
    - (iv) të ardhura të tjera;
    - (v) përfitime të paguara apo të pagueshme (të analizuara, psh. për pension pleqërie, paaftësi në punë apo vdekje, dhe pagesa fikse që kryhen vetëm një herë).
    - (vi) shpenzime administrative;
    - (vii) shpenzime të tjera;
    - (viii) tatim /taksa mbi të ardhurat;

- (ix) fitimet apo humbjet prej tërheqjes nga investimet, dhe ndryshimet në vlerën e investimeve; dhe
  - (x) kalimi nga një skemë e mëparshme tek skema aktuale, ose kalimi nga skema aktuale drejt skemave të tjera.
- (c) përshkrim i politikave për financim.
- (d) Për skemat e përfitimeve të përcaktuara, vlera aktuale aktuariale e përfitimeve për pension të premtuara (që bën dallimin ndërmjet përfitimeve të kushtëzuara dhe atyre të pakushtëzuara) bazohet në përfitimet e premtuara sipas kushteve të skemës për punën e kryer deri në atë datë duke përdorur nivelin aktual ose nivelet e projektuara të pagës; ky informacion mund të përfshihet në raportin shoqërues aktuarial që i bashkëlidhet pasqyrave financiare përkatëse; dhe
- (e) për skemat e përfitimeve të përcaktuara, të jepen hipotezat aktuariale kryesore dhe metoda e përdorur për llogaritjen e vlerës aktuale aktuariale të përfitimeve për pension të premtuara.
- 36 Raporti i skemës së përfitimeve për pension përmban një përshkrim të skemës si pjesë e pasqyrës financiare, ose në një raport të veçantë. Raporti mund të përmbajë sa më poshtë:
- (a) emrat e punëdhënësve dhe grupi i punëmarrësve i përfshirë në të.
  - (b) numri i pjesëmarrjeve që marrin përfitime dhe numri i pjesëmarrësve të tjerë, sipas klasifikimit
  - (c) lloji i skemës —kontribute apo përfitime të përcaktuara;
  - (d) shënim nëse pjesëmarrësit kontribuojnë në skemë
  - (e) përshkrim i përfitimeve për pension të premtuara pjesëmarrësve;
  - (f) përshkrim i skemave për kushtet e përfundimit të skemës. dhe
  - (g) ndryshime në pikat (a) deri në (f) gjatë periudhës së përfshirë në raport.

Praktika ku përmenden dokumente të tjera përshkruese të skemës, të cilat përdoruesit mund t'i gjejnë vetë dhe lehtë, dhe të përfshihen vetëm informacionet për ndryshimet pasuese, është praktikë e zakonshme.

## **Data e Hyrjes në Fuqi**

---

- 37 Ky Standard hyn në fuqi për pasqyrat financiare të skemave të përfitimeve për pensione pleqërie që përfshijnë periudhat nga data 1 Janar 1998, dhe më pas.